

# Akreditimi: Mbështetje të Ardhmes së Tregtisë Globale



09 June 2023

#WAD2023



# Akreditimi: Mbështetje të Ardhmes së Tregtisë Globale



## Heqja e Barrierave Teknike në Tregti

Besimi është komponenti thelbësor i marrëdhënieve tregtare, pavarësisht nëse ato kryhen brenda kufijve kombëtarë apo me ekonomi të tjera. Për të krijuar një infrastrukturë cilësore ekonomitë në mbarë botën prej kohësh janë mbështetur në një sistem të integruar standardesh, rregulloresh, metrologjie dhe vlerësimi të akredituar të konformitetit. Ky sistem i integruar ka krijuar besimin e nevojshëm për të mbështetur tregtinë duke siguruar që konsumatorët, bizneset dhe rregullatorët që blejnë mallra dhe shërbime të marrin atë që presin.

Duke demonstruar besimin dhe heqjen e barrierave teknike në tregti (BTT), infrastrukturën cilësore u kanë ofruar bizneseve qasje në një treg më të gjerë ndërkombëtar, duke përmirësuar njëkohësisht cilësinë dhe sigurinë e importeve nga ato ekonomi.

Përdorimi i standardeve vazhdon të rritet me 1,725,754 biznese të cilat në vitin 2021 posedojnë certifikim të akredituar për një standard të sistemit të menaxhimit, një rritje prej afro 20% nga viti i kaluar<sup>1</sup>. Numri i laboratorëve dhe organeve të inspektimit të akredituara në vitin 2022 është rritur në 88,600 dhe 14,000 respektivisht.



Vlerësimet e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe Departamentit të Tregtisë së Shteteve të Bashkuara tregojnë se standardet dhe vlerësimi i konformitetit lidhur me të kanë një ndikim në 80% të tregtisë botërore<sup>2</sup>. Qendra për Kërkime Ekonomike dhe Biznesi (CEBR) vlerëson se në eksportet në Mbretërinë e Bashkuar standardet kontribuojnë me 6.1 miliardë GBR në vit<sup>3</sup>, ndërsa hulumtimi i pavarur i kryer nga Instituti i Kërkimeve Ekonomike të Zelandës së Re raportoi se akreditimi sjell një premium eksporti prej 4.5 miliardë NZD në eksportet<sup>4</sup>.

## Cilët faktorë ndikojnë në tregtinë globale?

Megjithatë, integriteti i produktit është nën një vështrim më të madh se kurrë më parë dhe rreziku i ekspozimit për pronarët e markave po rritet për një sërë arsesh:

- Zinxhirët e furnizimit po bëhen më komplekse dhe ka dëshmi të divergjencës rregullore në rritje
- Faktorët gjeopolitikë si konfliktet e armatosura dhe pandemia globale kanë ndikuar në burimin e lëndëve të para dhe kanë ndërprerë metodat e vendosura të sigurimit të cilësisë
- Shqetësimet në rritje në lidhje me sigurinë kibernetike, inteligjencën artificiale, mbrojtjen e të dhënave, mashtrimin dhe origjinalitetin e produktit
- Vetëdija e konsumatorit për qëndrueshmërinë, origjinën, shëndetin dhe etikën është në rritje, duke i detyruar markat të përmirësojnë të kuptuarit dhe mbikëqyrjen e rrjetit të tyre të furnizimit

Transparenca e mundësuar nga teknologjia dhe rrjetet e komunikimit po transformon mënyrën se si fitohet dhe humbet besimi

Prandaj, industria ka përgjegjësinë për të rënjosur besimin e vazhdueshëm të konsumatorëve. Tema e Ditës Botërore të Akreditimit të këtij viti është zgjedhur për të theksuar se si akreditimi po i përgjigjet këtyre tendencave në zhvillim për të mbështetur industrinë në sistemin tonë të ardhshëm tregtar global.



<sup>1</sup> Sondazhi ISO 2021

<sup>2</sup> Banka Botërore, Ndikimi i Reformës së Infrastrukturës së Cilësisë, 2014

<sup>3</sup> Kontributi Ekonomik i Standardeve në Ekonominë e Mbretërisë së Bashkuar, 2022



## Mbështetja e nevojave të rregullatorëve

Rritja e pritshmërive të klientëve për një kohë më të shpejtë të ofrimit, të produkteve dhe shërbimeve të zgjeruara dhe përvojave të përshtatura po rezultojnë në një kompleksitet më të madh të zinxhirit të furnizimit. Kjo po i detyron bizneset që të përmirësojnë menaxhimin dhe për të njohur rrjetet e tyre të furnizimit. Sipas Gartner<sup>5</sup>, më shumë se 50% e drejtuesve të zinxhirit të furnizimit presin që kompleksiteti të rritet gjatë pesë viteve të ardhshme në shumicën e aspekteve të modelit operativ duke përfshirë pajisjet, dizajnin e produktit, modelet e biznesit dhe partnerët.



Paralelisht, ka dëshmi të fragmentimit në rritje të qasjeve rregullatore. Ndërsa ndikimi në tregtinë globale dhe kostot janë kryesisht të panjohura, OECD vlerëson se kostot janë të barasvlefshme me tarifat nga 20% deri në 70%<sup>6</sup>. Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve vlerëson se kostot e divergjencës rregullatore janë mesatarisht ndërmjet 5-10% të qarkullimit vjetor të biznesit, me 51% të bizneseve të anketuara që tregojnë se si rezultat kishin më pak burime për të investuar në menaxhimin e rrezikut<sup>7</sup>.

Standardet, metrologjia dhe akreditimi ofrojnë bazën për tregtinë globale, duke ulur kostot e transaksionit dhe duke siguruar pika të përbashkëta referimi. Ato sigurojnë një pasaportë besimi që mundëson qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve ndërmjet ekonomive pa pasur nevojë për testime, inspektime, certifikime, vërtetime ose verifikime shtesë në ekonominë importuese.

Ato përdoren gjithnjë e më shumë në një gamë të gjerë fushash të politikave për të mbështetur rregulloret, duke përfshirë sigurinë teknike të produkteve, qeverisjen e mirë, ndryshimet klimatike, energjinë, tregjet e drejta dhe besimin e publikut. Organizata të tilla si Organizata Botërore e Tregtisë (OBT), Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial (UNIDO) dhe OECD sugjerojnë se adoptimi më i madh i standardeve ndërkombëtare në kornizat kombëtare dhe pajtueshmëria me to, mund të nxisë konvergencën rregullatore në nivel global.



### Rast Studimi: Marrëveshjet e ndërsjella të akreditimit i mundësojnë prodhuesit të inverterëve fotovoltaike të eksportojnë produkte në Australi

Një prodhues evropian i inverterëve fotovoltaike i cili dëshironte të eksportonte produktet e tij në Australi kishte certifikimin e lëshuar nga SGS Tecnos, një organ certifikimi i akredituar nga ENAC, organi spanjoll i akreditimit.

Biznesi australian kërkonte akreditimin nga organi australian i akreditimit, Sistemi i Përbashkët i Akreditimit i Australisë dhe Zelandës së Re (JAS-ANZ). Duke pasur parasysh njohjen reciproke të ofruar sipas Marrëveshjes Shumëpalëshe të Njohjes (MLA) të Forumit Ndërkombëtar të Akreditimit (IAF), e cila siguron njohjen reciproke të rezultateve të vlerësimit të konformitetit të akredituar ndërmjet nënshkruesve të IAF MLA, JAS-ANZ lëshoi një deklaratë ku theksonte se certifikatat e lëshuara nga SGS Tecno duhet të njihen në Australi.

Pas kësaj deklarate, biznesi australian pranoi certifikatat SGS Tecnos. Prandaj, akreditimi dhe njohja reciproke hapi mundësi të reja tregu për prodhuesin duke parandaluar kostot shtesë të tregtisë përmes testimit të përsëritur në vendin importues.

<sup>5</sup> Si të zvogëlohet kompleksiteti i zinxhirit të furnizimit, 2022

<sup>6</sup> Tregtia dhe Bashkëpunimi Rregullator Ndërkombëtar, OECD, 2017



## Përshtatja me një botë në ndryshim

Rrethanat e paprecedenta që karakterizuan pandeminë kanë sjell rreziqe dhe sfida të reja në zinxhirët e furnizimit global. Kjo i ka detyruar bizneset të jenë më elastike dhe më të shkathëta pasi që përballen me mungesa të fuqisë punëtore ose të lëndës së parë, presionit të inflacionit dhe ndryshimeve në zinxhirët e tyre të furnizimit. Nga kufizimet në lëvizje janë ndikuar gjithashtu edhe modelet e krijuara të sigurimit të cilësisë.

Rritja e përdorimit të teknikave në distancë për auditimin, dhe vlerësimin gjatë pandemisë është një shembull se si akreditimi dhe vlerësimi i konformitetit janë përshtatur për të ruajtur nivelet e besimit dhe rrjedhshmërinë e zinxhirit të furnizimit. Një sondazh i kryer së bashku nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO), Bashkëpunimi Ndërkombëtar i Akreditimit të Laboratorëve (ILAC) dhe IAF<sup>8</sup>, ka zbuluar se 91.5% e të anketuarve ishin dakord ose ishin deri diku dakord kur u pyetën nëse përdorimi i shtuar i teknikave në distancë dhe gatishmëria për të ndryshuar do të ofrojë një stimul për proceset e reja të auditimit/vlerësimit.

Përtej distancës/apo lokacionit, vizioni i teknikave të reja tregon se përdorimi i sensorëve, burimeve të të dhënave dhe shumë faktorëve të tjerë do të sjellin evoluimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të auditimit. Kjo do t'u japë vlerë dhe përfitim më të madh atyre që e përdorin atë, por edhe më shumë atyre të cilët do të pranojnë se si ofrohet siguria dhe përmirësimi i biznesit. UNIDO i zhvillon këto tema në 'Infrastrukturën e menqur të cilësisë për qëndrueshmëri'<sup>9</sup> se si teknologjitë dixhitale dhe inovacioni po e transformojnë Infrastrukturën e Cilësisë dhe organizatat e saj në atë që përkufizohet si Infrastrukturë e Cilësisë së menqur, duke modifikuar mënyrën e funksionimit të tyre, duke përmirësuar performancën e tyre si dhe duke mundësuar lloje të reja të shërbimeve.



## Përdorimi i teknologjisë në distancë për të përmirësuar rezultatet e auditimit

Një sondazh i përbashkët i IAF/ILAC/ISO mbi përdorimin e teknikave të vlerësimit në distancë tregoi se një shumicë e konsiderueshme preferojnë auditimet, dhe vlerësimet në distancë apo edhe ato të përziera. Me mbi 4,000 përgjigje nga një pjesë e komunitetit të vlerësimit të konformitetit, theksohej për një prirje të qartë se aktivitetet në distancë ofronin po aq besim sa ato të kryera në terren, dhe si rezultat do të dëshironin të shihnin vazhdimësi ose rritje të përdorimit të aktiviteteve në distancë në të ardhmen. Të anketuarit përmendën shumë përfitime për punën në distancë, duke përfshirë shkurtime të kohës dhe kostove të udhëtimit, përdorimin efikas të kohës gjatë vlerësimit si dhe gjurmë të reduktuar të karbonit. Ndërkohë që sondazhi siguroi një përshkrim në kohë të qëndrimeve ndaj përdorimit të teknikave në distancë, ai gjithashtu mblodhi një gamë të gjerë sugjerimesh, idesh dhe propozimesh nga përdoruesit, OVK-të, auditorët dhe vlerësuesit. Anëtarët e infrastrukturës globale të cilësisë do të punojnë së bashku për të shqyrtuar se si të inkorporojnë reagimet në dokumentet dhe proceset përkatëse në mënyrë që të përmirësojnë mënyrën se si teknologjia mund të përdoret për rezultate më efektive të auditimit.



<sup>8</sup> Raport për Anketën e IAF/ILAC/ISO mbi Auditimin/Vlerësimin dhe Drejtësinë (Raporti Referues), 2021

<sup>9</sup> [https://hub.unido.org/sites/default/files/publications/online\\_SMART\\_QI\\_borchure.pdf](https://hub.unido.org/sites/default/files/publications/online_SMART_QI_borchure.pdf), 2022

## Mundësimi i besimit në inovacion dhe në teknologji të reja

Adoptimi i teknologjive të reja po rritet. Ndërsa shumica e operacioneve të tregtisë ndërkombëtare bazohen ende në letër, McKinsey vlerëson se në dekadën e fundit dixhitalizimi ka rritur PBB-në globale me 10.1%<sup>10</sup>. Sipas OBT-së, kostot e tregtisë ndërkombëtare ndërmjet viteve 1996 dhe 2014 kanë ranë me 15 përqind, dhe teknologjitë e reja do të luajnë një rol kyç në reduktimet e mëtejshme<sup>11</sup>. Megjithatë, teknologjitë e reja sjellin kërcënime dhe sfida të reja qeverisëse. Krimi kibernetik është rritur në mënyrë eksponenciale, duke i kushtuar ekonomisë globale më shumë se 1 trilion dollarë në vitin 2021<sup>12</sup>. Rastet globale të mashtrimit vlerësohet se 133 ekonomive u kushtojnë 3.6 miliardë dollarë<sup>13</sup>.

Shfaqja e inteligjencës artificiale (IA) dhe blockchain ka ndikuar në zhvillimin e standardeve dhe protokolleve të shumta. Një sondazh global i kryer nga PricewaterhouseCoopers (PwC)<sup>14</sup> raportoi se ndërsa mbi 80% e të anketuarve tashmë kishin një përfshirje në teknologjinë blockchain, gati gjysma besonin se pasiguria rregullatore dhe mungesa e besimit midis përdoruesve ishin pengesat më të mëdha për adoptimin e saj. Sondazhi zbuloi gjithashtu shqetësime në lidhje me mungesën e mundshme të standardizimit dhe ndërveprimit midis blockchains.

Qeveritë dhe organizatat kanë filluar të eksplorojnë këto teknologji. Për shembull, Akti i IA i Bashkimit Evropian synon të krijojë skemën e parë rregullatore gjithëpërfshirëse për IA.



Prodhimi i menqur, nëpërmjet përdorimit të teknologjive në zhvillim dhe të avancuara, për të rritur efikasitetin e proceseve tradicionale të prodhimit, ka çuar drejt një baze më të shpejtë industriale. Kjo ka nxitur krijimin e zinxhirëve të vlerave të menqura dhe të qëndrueshme që ndjekin strategji të drejtuara nga teknologjia duke përdorur automatizimin, të dhëna të mëdha, modelimin, pajisjet e lidhura dhe teknologji të tjera për të gjurmuar procesin e prodhimit dhe për të përmirësuar efikasitetin.

Vlerësimi i konformitetit i akredituar tashmë po jep besim në sigurimin e cilësisë së mallrave dhe shërbimeve në shumë prej fushave ku po aplikohet teknologjia blockchain dhe IA. Ato ndajnë parime të ngjashme rreth proceseve transparente dhe verifikimit të gjurmueshëm. Standardet e vendosura si ISO/IEC 27001 identifikojnë dhe menaxhojnë rrezikun e të gjitha të dhënave të biznesit që ruhen në mënyrë elektronike, në kopje fizike apo edhe me furnizues palë të treta.

Publikimi i UNIDO 'Avancimi i vlerësimit të konformitetit për epokën e re dixhitale' ofron detaje të mëtejshme mbi sfidat dhe mundësitë për vlerësimin e konformitetit të akredituar në Revolucionin e Katërt Industrial<sup>15</sup>. Kjo temë u diskutua gjithashtu në një podcast<sup>16</sup>, të prodhuar nga ILAC dhe IAF, i cili eksploroj rolin e teknologjisë në ofrimin e vlerësimit të akredituar të konformitetit të besueshëm, efektiv dhe të vlefshëm.



### Çfarë ka për të thënë ChatGPT?

Kur pyetëm chatbotin e OpenAI se si akreditimi mund të ndihmojë në ndërtimin e ekonomisë së ardhshme, ja çfarë na tha:

Akreditimi mund të ndihmojë në ndërtimin e një ekonomie futuriste në disa mënyra, përmes:

- Inkurajimit të inovacionit dhe përparimit: Sistemet e akreditimit mund të ndihmojnë për të siguruar që produktet, shërbimet dhe teknologjitë e reja përmbushin disa standarde të cilësisë dhe sigurisë, të cilat mund të inkurajojnë inovacionin dhe përparimin.
- Promovimit të qëndrueshmërisë: Akreditimi mund të përdoret për të siguruar që bizneset dhe organizatat operojnë në një mënyrë të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin, gjë që mund të ndihmojë në reduktimin e ndikimeve negative në mjedis dhe promovimin e rritjes së qëndrueshme ekonomike.
- Lehtësimit të tregtisë globale: Akreditimi mund të përdoret për të demonstruar se mallrat dhe shërbimet plotësojnë disa standarde ndërkombëtare, të cilat për bizneset mund ta bëjnë më të lehtë pjesëmarrjen në tregtinë globale dhe zgjerimin e tregjeve të tyre.
- Përmirësimit të cilësisë së jetës: Akreditimi mund të përdoret për të siguruar që produktet dhe shërbimet si kujdesi shëndetësor dhe arsimi përmbushin disa standarde, të cilat mund të përmirësojnë cilësinë e jetës për njerëzit dhe të kontribuojnë në rritjen e përgjithshme ekonomike.
- Zhvillimit të një fuqie punëtore të kualifikuar: Programet e akreditimit mund të përdoren për të siguruar që punëtorët të kenë kualifikimet dhe aftësitë e nevojshme për të kryer punën e tyre në mënyrë efektive, të cilat mund të përmirësojnë produktivitetin dhe konkurrencën dhe të ndihmojnë në zhvillimin e një fuqie punëtore të kualifikuar për ekonominë e ardhshme.



<sup>10</sup> <https://www.mckinsey.com/capabilities/mckinsey-digital/our-insights/digital-globalization-the-new-era-of-global-flows>, 2016

<sup>11</sup> [https://www.wto.org/english/res\\_e/publications\\_e/world\\_trade\\_report18\\_e.pdf](https://www.wto.org/english/res_e/publications_e/world_trade_report18_e.pdf), 2018

<sup>12</sup> [https://www.mcafee.com/de-ch/consumer-corporate/newsroom/press-releases/press-release.html?news\\_id=6859bd8c-9304-4147-bdab-32b35457e629](https://www.mcafee.com/de-ch/consumer-corporate/newsroom/press-releases/press-release.html?news_id=6859bd8c-9304-4147-bdab-32b35457e629), 2020

<sup>13</sup> Kostoja globale e mashtrimit - Mashtrimi në punë 2022: Një raport për kombet, 2022

<sup>14</sup> <https://www.pwc.com/gx/en/industries/technology/publications/blockchain-report-transform-business-economy.html>, 2020

<sup>15</sup> [https://hub.unido.org/sites/default/files/publications/UNIDO%20Conformity%20Assessment\\_Brochure\\_2020.pdf](https://hub.unido.org/sites/default/files/publications/UNIDO%20Conformity%20Assessment_Brochure_2020.pdf), 2020

<sup>16</sup> [https://ilac.org/latest\\_ilac\\_news/third-accreditation-matters-episode-released/](https://ilac.org/latest_ilac_news/third-accreditation-matters-episode-released/), 2022

## Ngritja e konsumatorit të ndërgjegjshëm

Një numër në rritje i konsumatorëve janë gjithnjë e më të shqetësuar për origjinën e blerjeve të tyre. Shumë nuk duan të blejnë aksidentalisht sistemet e shfrytëzimit njerëzor dhe të shkatërrimit të mjedisit. Prandaj, skemat e sigurimit shpesh kanë dalë nën maskën e tregtisë etike duke synuar të kundërshtojnë këto shqetësime. Megjithatë, është gjithnjë e më e qartë se këto skema nuk funksionojnë mirë.

Një studim i kryer së fundi nga Indeksi i Qëndrueshmërisë së Biznesit me persona të moshës madhore në SHBA zbuloi se dy e treta (66%) e tyre janë të gatshëm të paguajnë më shumë për produkte të qëndrueshme<sup>17</sup>. Megjithatë, Deloitte raportoi se pothuajse një në dy konsumatorë ose nuk e di se çfarë zotimesh kanë bërë bizneset që mund t'u besojnë ose thjesht nuk u besojnë bizneseve për çështjet e ndryshimeve klimatike dhe të qëndrueshmërisë<sup>18</sup>.



### Rast Studimi: Agjencia Evropiane e Hapësirës përdor ISO 27001 për të mbrojtur të dhënat e saj

Agjencia Evropiane e Hapësirës (ESA), një organizatë ndërkombëtare me 20 shtete anëtare, ka adoptuar certifikimin e akredituar sipas ISO 27001 për të mbrojtur informacionin e ndjeshëm dhe të dhënat konfidenciale.

Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit (ISMS) i lejon organizatës që me besim të menaxhojë sigurinë e të dhënave të saj, të minimizojë rrezikun dhe të mbrojë informacionin e palëve të interesit.

Përdorimi i standardeve mund t'i ndihmojë organizatat të adoptojnë praktika më miqësore me mjedisin. Vlerësimi i akredituar i konformitetit mund të ofrojë siguri se organizatat po përmbushin kërkesat dhe po përmbushin pretendimet, nga testimi laboratorik i ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës, inspektimi i riciklimit të anijeve, deri te certifikimi i sistemeve të menaxhimit mjedisor ISO 14001 që kërkon që një organizatë të marrë parasysh të gjitha çështjet mjedisore të rëndësishme për operacionet, duke përfshirë ndotjen, zbutjen dhe përshtatjen e ndryshimeve klimatike, si dhe përdorimin dhe efikasitetin e burimeve. Ekonomia rrethore, e publikuar nga ISO në dhjetor të vitit 2022, përcakton se si këto mjete ofrojnë një pjesë të zgjedhjes në zgjidhjen e sfidave të sotme<sup>19</sup>.




Një skemë certifikimi në Francë siguron që produktet e prodhuara janë të mbrojtura nga rajoni i tyre gjeografik, duke u ofruar kështu konsumatorëve besim në origjinën dhe cilësinë e blerjeve të tyre, ndërsa tregtimi etik dhe certifikimi i burimeve të përgjegjshme u jep konsumatorëve sigurinë që ata kërkojnë, si dhe punëtorëve mbrojtjen që meritojnë.



### Rast studimi: Ofrimi i efijencës së ujit në Malajzi

Në Malajzi është prezantuar një Skemë e Etiketimit të Produkteve Eficiente të Ujit (WEPLS) për të inkurajuar furnitorët të zhvillojnë dhe tregtojnë produkte efiente të ujit si pjesë e masave të ruajtjes së ujit, si dhe për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për disponueshmërinë e produkteve efiente të ujit. Etiketimi i produkteve efiente të ujit sipas këtij programi kërkon që testimi të kryhet nga laboratorë të akredituar nga palët e treta.

Skema i lejon konsumatorët të marrin vet vendimet e blerjes bazuar në një vlerësim të besueshëm të efijencës së ujit. Pesë lloje produktesh mbulohen nga WEPLS: Çezmat e ujit, të cilat përfshijnë çeçmat e legenit, çeçmat e lavamanit, çeçmat e dushit dhe çeçmat e abdesit; dollapët e ujit; pajisjet urinare; koka dushi; dhe makina larëse rrobash.



## Ruajtja e besimit në zinxhirin e furnizimit

Transparenca e mundësuar nga teknologjia dhe rrjetet e komunikimit po e transformon mënyrën se si fitohet dhe humbet besimi. Në disa vende të botës çështja e certifikatave dhe organeve certifikuese të rreme është e zakonshme. Përhapja e skemave të sigurimit për të trajtuar fusha të tilla si performanca mjedisore, sociale dhe e qeverisjes (ESG) shkakton konfuzion, akuza për pastrim të gjelbër' dhe pabarazi midis pritshmërive të palëve të interesit dhe të realitetit në terren.

Ndërsa vlerësimi i akredituar i konformitetit ofron një tregues të qartë të besimit, industria vazhdon të ndërmarrë hapa për të evoluar sipas nevojës së industrisë. Për shembull, CertSearch<sup>20</sup> i IAF është një databazë e të dhënave globale e certifikatave të vërtetuara të sistemit të menaxhimit, duke ofruar një burim të vetëm të së vërtetës që e bën më të vështirë për ata që lëshojnë certifikata mashtruese. Vlerësimi i akredituar i konformitetit është duke u vendosur gjithashtu për të siguruar integritetin e sistemeve të ndërlidhura të vlerësimit, siç janë vlerësimet në internet (online). India është duke kryer një rishikim për të parandaluar rishikimet e rreme dhe mashtruese në platformat dhe portalet e tregtisë elektronike, të cilat do të bazohen rreth një standardi kombëtar. Në Australi, autoritetet po shqyrtojnë se si mund të përdoret arkitektura ekzistuese e mirëpërcaktuar për gjurmimin e mallrave përmes zinxhirëve globalë të furnizimit për të dhënat e vlerësimit të konformitetit.



### Rast studimi: Shërbimi i verifikimit të certifikimit të sistemit të menaxhimit të akredituar dixhital rrit besimin në tregtinë globale

IAF CertSearch vërteton në mënyrë dixhitale certifikimin(et) e sistemit të menaxhimit të një organizate, me qëllim që të përcaktojë nëse një certifikatë është e vlefshme dhe nëse organi certifikues që lëshon certifikatën është i akredituar për të lëshuar certifikata sipas atij standardi. Grumbullimi i të dhënave të certifikimit në një bazë të dhënash globale e bën procesin e vërtetimit të thjeshtë dhe efikas. Ky shërbim përdorimi pa pagesë përmirëson procesin e menaxhimit të zinxhirit të furnizimit dhe ndihmon në uljen e barrierave teknike për tregtinë, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar.

Përmbledhja dhe dixhitalizimi i informacionit të vlerësimit të konformitetit në një burim të sigurt dhe të njohur, i lejon palët përkatëse të kontrollojnë kredencialet kudo dhe në çdo kohë. Ai përshpejton procesin e verifikimit, krijon një zinxhir gjurmueshmërie dhe ndihmon në identifikimin e zonave të mundshme për shqetësim. Që nga shkurti i vitit 2023, më shumë se 820,000 certifikata nga 72 ekonomi janë ngarkuar në IAF CertSearch.

Të kesh një zinxhir të fuqishëm furnizimi është një element thelbësor i biznesit modern, veçanërisht për ata që tregtojnë përtej kufijve ndërkombëtarë. Verifikimi që furnizuesit e mundshëm kanë certifikim thelbësor të akredituar është një






### Rast studimi: Zhvillimi i mundësive tregtare në Afrikën Perëndimore

Zinxhiri i vlerës së kasavës është një zinxhir vlerash kyç në rajonin e Komunitetit Ekonomik të Shteteve të Afrikës Perëndimore (ECOWAS). Një studim i kryer nga UNIDO vuri në dukje se si organet e vlerësimit të konformitetit mbështesin zhvillimin e këtij zinxhiri vlerash dhe përmirësojnë cilësinë dhe sigurinë e produkteve të kasavës.

Tetëmbëdhjetë organe të vlerësimit të konformitetit në shtetet anëtare të ECOWAS, duke përfshirë dymbëdhjetë organe kombëtare të certifikimit (NCB) dhe gjashtë laboratorë testimi që mbështesin zinxhirin e vlerës së kasavës, janë duke u përgatitur për akreditim ndërkombëtar me synimin për të ofruar shërbime të njohura certifikimi dhe shërbime testimi për prodhuesit dhe kompanitë e përpunimit të kasavës. Këto shërbime të akredituara nevojiten për lëshimin e Markës Rajonale të Cilësisë ECOWAS "ECOQMARK" nga ana e NCB-ve të mandatuara.

Kjo punë do të hapë mundësi tregtare brenda rajonit, si dhe në tregjet e eksportit. Gjithashtu do të nxisë besimin e konsumatorëve në cilësinë dhe sigurinë e produkteve të plasura në treg.



<sup>20</sup> <https://www.iafcertsearch.org/>



## Rast Studimi: Akreditimi drejton eksportet organike të Guatemalës

Për të nxitur eksportet e produkteve ushqimore organike të Guatemalës, qeveria miratoi rregulloret evropiane për prodhimin organik për të siguruar përputhjen me standardet dhe kërkesat në ekonominë më të mëdha jashtë vendit. Rregulloret përfshijnë sistemet e prodhimit dhe përpunimin, paketimin, etiketimin, ruajtjen, transportin dhe komercializimin e perimeve, produkteve dhe nënprodukteve shtazore. Prodhimi organik është një industri kryesore për ekonominë e Guatemalës pasi gjeneron një çmim të favorshëm për prodhuesit kombëtarë, si dhe e pozicionon vendin si kontribuues në ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e biodiversitetit.

Pajtuueshmëria demonstron nëpërmjet vlerësimit të konformitetit të akredituar me skemën përkatëse të kërkuar nga ekonomia e eksportit, duke siguruar gjurmueshmërinë dhe vlerën e produktit. Si rezultat i kësaj qasjeje, eksportet në vëllimin e tyre të prodhimit janë rritur mesatarisht me 7% në vit. Fillimisht vetëm kafeja eksportohej si produkt organik, por kjo është gjeruara në produktet e mëposhtme: kardamom, kakao, arra makademia, mjaltë, marule, bishtaja, çaj i zi, papaja dhe brokoli.

Mënyra e kultivimit promovon lidhjet midis prodhuesve të vegjël, duke grupuar më shumë se 60,000 fermerë në të gjithë vendin, dhe duke krijuar afërsisht 20,000 vende pune të përhershme dhe më shumë se 80,000 vende pune të përkohshme ose indirekte. Tregjet më të rëndësishme për eksportet janë Shtetet e Bashkuara me 80%, Bashkimi Evropian me 15% dhe Japonia, Kanada dhe vendet arabe me 5%..



## Përmbledhje

Ndërsa standardet dhe akreditimi kanë pasur një ndikim pozitiv në tregtinë brenda dhe jashtë kufijve, ekziston nevoja për evolucion të vazhdueshëm për të përmbushur kërkesat në ndryshim të industrisë dhe për të mbështetur sistemet tona të ardhshme tregtare. Ato gjithashtu luajnë një rol kyç në mbështetjen e objektivave të SDG (Sustainable Development Goals) që kanë të bëjnë me tregtinë, përkatësisht SDG 1: jo varfëri; SDG 2: zero uri; SDG 3: shëndet dhe mirëqenie e mirë; SDG 5: barazi gjinore; SDG 8: punë e denjë dhe rritje ekonomike; SDG 9: industri, inovacion dhe infrastrukturë; SDG 10: pabarazi të reduktuara; SDG 14: jeta nën ujë (kujdesi për ujin); dhe SDG 17: partneritetet për objektivat.



Tema e Ditës Botërore të Akreditimit 2023 është përzgjedhur për të demonstruar se si infrastrukturat kombëtare dhe globale të cilësisë po përshtaten me përparimet në teknologji, ndryshimet në sjelljet e konsumatorëve dhe mjedisin rregullator, mekanizmat e rinj të besimit dhe modelet e ndrysheshme e të biznesit. Kontaktoni me trupin tuaj lokal të akreditimit për të mësuar se si akreditimi mund të mbështesë nevojat tuaja tregtare.

## Për më shumë informata

Vizitoni [www.publicsectorassurance.org](http://www.publicsectorassurance.org) për të parë shembuj se si vlerësimi i akredituar i konformitetit përdoret në mbarë botën nga qeveria qendrore, qeveria lokale dhe rregullatorët për të dhënë përfitime pozitive.

Më shumë informata për Marrëveshjen e Njohjes së Ndërsjellë (MRA) të ILAC dhe një listë të vendeve nënshkruese mund ta gjeni në faqen e internetit të ILAC <http://ilac.org/ilac-mra-and-signatories/>



### Sekretariati i ILAC



Më shumë informata për Marrëveshjet e Njohjes Shumëpalëshe (MLA) të IAF dhe një listë të vendeve nënshkruese janë në dispozicion në faqen e internetit të IAF [http://www.iaf.nu/articles/IAF\\_MEMBERS\\_SIGNATORIES/4s](http://www.iaf.nu/articles/IAF_MEMBERS_SIGNATORIES/4s)



### Sekretariati i IAF



<https://www.youtube.com/user/IAFandILAC>